

INTERFERENCA E DY FORMAVE TË SHKURTRA TË LETËRSISË GOJORE

LEONTINA GEGA MUSA
Instituti Albanologjik, Prishtinë, Kosovë
leontina_gm@hotmail.com

AKTET V, 4: 672 - 676, 2012

PERMBLEDHJE

Interferenca ndërmjet zhanreve të ndryshme të letërsisë gojore ka zgjuar kërkuesin e studiuesve nga fusha e studimeve folkloristike në vazhdimësi. Një interferencë e tillë ekziston edhe përbrenda formave të shkurtra, po që për këtë rast kam veçuar interferencën e fjalës së urtë me gjëgjëzën. Këtë interferencë mund ta analizojmë jo vetëm në ngjashmërinë e ndërtimit të jashtëm, e cila bazohet në elementet dhe funksionin e përbashkët të tyre, por edhe në strukturën semiotike të ndërtimit të brendshëm. Padyshim se interferencat ndërzanërore vijnë në radhë të parë si rrjedhojë e një forme tekstore të shkurtër, për të cilat janë përdorur struktura arkaike të fjalive, si dhe e një ngjashmërie tematike të këtyre dy zhanreve edhe përkundër dallimit në pasqyrimin e objektit të shfaqur në to. Një interferencë e theksuar vërehet gjithashtu edhe në funksionin e këtyre zhanreve

Fjale kyce: interferenca, format e shkurtra, fjalë e urtë, gjëgjëzë.

SUMMARY

Interference between different genres of oral literature has increased curiosity at researchers from folkloristic study areas, in continuity. Interference like this exists even within short forms, but for this case I have selected the interference of proverbs and riddles. This interference we can analyze not only in the similarity of external construction, which is based on elements and their common functions, but also on semiotic structure of internal construction. Undoubtedly inter-genres interferences come first in line as a result of a short textual form, for which are used archaic structures of sentences, and a similarity in topics between these two genres even despite the difference in reflection of object presented on it. One emphasized interference is noticed also in function of these genres.

Key words: interference, short forms, proverbs, riddles.

1. Hyrje

Kur në krijimtarinë letrare gojore përdorim termin forma të shkurtra, që në gjuhën angleze sipas Taylor-it quhen *primary form* (formë primare), kemi parasysh ato krijime gojore me përmbajtje tekstore të shkurtër, të ndërtuar mbi një mikrostrukturë me bazë artistike, vlera e të cilave është e dukshme në përmbajtjet e tyre dhe e cila shfaqet si dëshmi e një përvojë jetësore, që bën ndikim në mënyrë racionale e emocionale në vetëdijen e njeriut. Për këtë arsye, studiuesit Pepicello dhe Green, zhanret si gjëgjëzat dhe fjalët e urta i quajnë “të zgjuara”(Pepicello dhe

Green,1984:123). Gjithashtu dëshmi e vlerës së këtyre formave është edhe fakti se format e shkurtra i mbijetuan *censurës preventive* që sipas studiuesve Jakobson dhe Bogatyrev në folklor mbeten vetëm ato forma të cilat vazhdojnë të jenë operative brenda një bashkësie të caktuar (Boskovic-Stuli,1971:23).

Studiues të ndryshëm nga fusha e folkloristikës, që janë marrë me studimin e formave të shkurtra shpesh herë i janë kthyer interferencës së fjalës së urtë me gjëgjëzën. Në folkloristikën botërore për këtë relacion të ndërsjellë janë bërë edhe studime të veçanta, siç është ai i Matti Kuusi-t,

“Southwest African Riddle-Proverbs” (Kuusi,1969:305-311) ose në gjuhën shqipe “Gjëegjëza-Proverba të Afrikës Jug-Perëndimore”, si dhe ai i George Milner, “From proverb to riddle and vice versa”(Milner,1970:84) ose në gjuhën shqipe “Nga proverbi në gjëegjëzë dhe anasjelltas”.

2. Interferencën ndërmjet dy zhanreve

Interferencën ndërmjet dy zhanreve të krijimtarisë letrare gojore (që në këtë rast është përdorur në kuptimin e ndikimit ndërmjet fjalës së urtë dhe gjëegjëzës), mund ta analizojmë mbi bazë të ngjashmërisë së ndërtimit të jashtëm, e cila ngjashmëri bazohet në elementet dhe funksionin e përbashkët të tyre, por edhe mbi bazë të strukturës semiotike të ndërtimit të brendshëm. Padyshim se një interferencë e ngushtë ndërmjet zhanrit të fjalës së urtë dhe asaj të gjëegjëzës në radhë të parë vjen si përkatësi e përbashkët e tyre në format e shkurtër, duke pasur të përbashkët një tekst të shkurtër e të ngjeshur, me ndërtim stilistikoritmik, si dhe një strukturë binare me karakter enigmatik. Po një interferencë e ngushtë vërehet edhe në funksionin e këtyre zhanreve. Nëse me fjalën e urtë shprehet e tërë përvoja jetësore, karakteret njerëzore, morali dhe mendimet filozofike që e preokupojnë njeriun, nëpërmjet gjëegjëzës mund të zbulojmë pikëpamjet e njeriut ndaj natyrës dhe shoqërisë, si dhe cilësitë dhe karakteristikat e veçanta të dukurive. Interferenca e theksuar që ka krijuar edhe një ngjashmëri ndërmjet këtyre dy zhanreve është e dukshme edhe në përbërjen strukturore të tyre, sepse që të dyja format kanë një element deskriptiv të ndërtuar në konstruksionin *temë-koment*, si dhe posedojnë dy lloje të përgjithshme, opozitare dhe joopozitare. Gjithashtu një segment tjetër afrie ndërmjet gjëegjëzës dhe fjalës së urtë është dhe forma tekstore e shkurtër për të cilat janë përdorur struktura arkaike të fjalive, si dhe ngjashmëria tematike e këtyre dy zhanreve edhe përkundër dallimit në pasqyrimin e objektit të shfaqur në to. Siç u cek më lartë, në folkloristikën botërore për këtë relacion interferues të ndërsjellë janë bërë

studime të veçanta, ndërkaq në folkloristikën tonë studiues që janë marr me këto forma të shkurtër kanë analizuar edhe relacionin fjalë e urtë – gjëegjëzë, kuptohet duke u bazuar në krijimet përkatëse të këtyre formave të krijimtarisë sonë gojore.

2. 1. Elementi deskriptiv

Për ngjashmërinë strukturore ndërmjet këtyre dy zhanreve, Alan Dundes në studimin “On the Structure of the Proverb” ose “Struktura e proverbave” (Dundes,1975,25:961-973) konstaton se, si fjalët e urta edhe gjëegjëzat përmbajnë elemente deskriptive, temë dhe koment të përbëra prej dy komponentësh: për atë që flitet dhe për atë çka i thuhet të parit. Edhe pse ky element deskriptiv të gjëegjëzat duhet të zbulohet, prapëseprapë në rrafshin logjiko-semantik, struktura e saj është po ajo si e fjalës së urtë që përmban element deskriptiv, ose temë dhe koment, por që të fjalë e urtë në bazë të informacionit kontekstual, supozohet se ndahet ndërmjet parashtruesit dhe dëgjuesit. Dundes veçon edhe një karakteristikë kontekstuale ndërmjet këtyre dy zhanreve, sepse ai shpesh imponon që një tekst i dhënë do të interpretohej si gjëegjëzë apo fjalë e urtë. Por, gjersa tek gjëegjëzat ky element deskriptiv dhe enigmatik është dhënë në formë të pyetjes, prej së cilës pritet një përgjigje, të fjalët e urta dëgjuesi vihet para një dileme ose enigme se kujt i referohet kjo thënie, prandaj dhe karakteri enigmatik i tyre, shpeshherë forcohet me përdorimin e figurave, si: simboli, epiteti, aliteracioni e onomatopeja, të cilat janë figura karakteristike të gjëegjëzave. Ky karakter enigmatik, i cili ngacmon dëgjuesin, në të dy rastet flet edhe për një interferencë të përbashkët dhe afri të këtyre dy zhanreve. Studiuesit Pepicello dhe Green në studimin “The Language of Riddles” (Gjuha e gjëegjëzave), aty ku bëjnë fjalë për strukturën komunikative të gjëegjëzës, theksojnë se ndryshe nga proverbat, zhanret tjera minore, me të cilat shpesh ato janë krahasuar, gjëegjëzat nuk shtojnë (zmadhojnë) shoqërueshmërinë. Ato shërbejnë, kundërshtojnë, gjenerojnë tension në një

atmosferë të garës, të cilat ato vetvetiu e nxisin. Parashtruesi i gjëegjzës përpiqet me qëllim të hutojë audiencën e tij, ndonëse konflikti, të cilin ai e provokon, është vendosur me deshifrimin e përgjigjes, të cilën e jep rivali; qëllimi i tij kurrë s'ka qenë i përmirësuar, bile as të zbusë tensionin e shkaktuar. Në enigmatikë një është lejuar – bile edhe kërkohet - vrazhdësia. Ajo ka fuqi të hutojë, të shqetësojë dhe të çarmatosë, brenda kufijve të përshkruar dhe miratuar me marrëveshje, një kundërshtar të zgjedhur, me një sulm që është i justifikueshëm dhe të cilat i gjejmë në pjesë të gjera të burimeve të gjëegjzave të përhershme joshëse (Pepicello dhe Green,1984:123-142).

Interferenca fjalë e urtë-gjëegjzë vazhdon të jetë në fokusin e interesimit të këtyre autorëve edhe në punimin studimor "The Proverb and Riddle as Folk Enthymemes" ose "Proverbat dhe gjëegjzat si entimema folklorike" (Green dhe Papicello,1986). Termi entimemë është përdorur në kuptimin e llojit të një strategjie retorike, ku parashtruesi i këtyre formave mbështetet në njohuritë kuptimore të përbashkëta me marrësin dhe supozon në mundësinë e një lidhjeje logjike ndërmjet tyre. Ky term është përdorur nga Aristoteli në *Retorikën* e tij. Relacioni fjalë e urtë-gjëegjzë në këtë studim zbërthehet mbi bazën e një ngjashmërie thelbësore dhe një ndryshimi thelbësor. Që të dy këto zhanre janë ndërtuar mbi bazë të metaforës, e cila te gjëegjzat e ka rolin e kamuflimit ose hutimit për të ardhur deri te përgjigjja, kurse te fjalët e urta metafora ndihmon për qartësimin e kuptimit të saj. Ky dallim vjen si pasojë e formës strukturore shprehëse të fjalës së urtë nga forma strukturore pyetëse që ka gjëegjza. Duke u fokusuar në marrëdhënien ndërmjet formës dhe funksionit, studiuesit në fjalë sqarojnë mendimin e tyre edhe për fjalën e urtë si formë retorike dhe e cila vlen edhe për gjëegjzën. Kështu Green dhe Pepicello e vërtetojnë konkludimin e Dundes-it se "Një interpretim i suksesshëm i gjëegjzës kërkon që dëgjuesi ta kuptojë logjikën e saj, pasi që sekuenca e tërë e pyetjes dhe përgjigjes të zbulohet, e te fjalët e urta, për këtë nevojitet bashkëbisedim ndërmjet parashtruesit dhe atij që përgjigjet.(...) Zakonisht gjëegjzat shfaqen në

formë të zakonshme të pyetjes dhe përgjigjes. Sipas kësaj në kontekstin e përditshëm në zakonisht parashtruesi pyetje prej të cilave presim përgjigje, ndërkaq te gjëegjzat qëllimi është që të parashtrohet pyetje së cilës nuk mund t'i përgjigjesh. Prandaj, supozohet se forma e gjëegjzës, si dhe qëllimi i interpretimit të tyre paraqet inversion. Një hulumtim më i thellë i gjëegjzave megjithatë rezultoi se ato nuk funksionojnë si inversion i pyetjeve normale të dëshmuara për informacion. Të vërtetën për këtë dëshmi e fitojmë nëse i analizojmë gjëegjzat nga një këndvështrim pragmatik i tyre", mendojnë Green dhe Pepicello. Konkluzioni i këtyre studiuesve është se rregullat gramatikore të cilat e determinojnë formën janë në thelb konvencionale dhe paraqesin përshkrim të formës së gjëegjzës në formë të pyetjes dhe përgjigjes. Principet e pragmaticitetit janë në thelb jokonvencionale në fakt ato motivohen sipas rregullave të konvencionit. Në rastin e gjëegjzave qëllimi është që të gjithë pjesëmarrësit të jenë në interaksion, ta kuptojnë dhe të dakordohen rreth logjikës speciale të gjëegjzave individuale. Është e qartë se ky qëllim nuk është i njëjtë, as nuk është që të nxjerr informacion. Sipas kësaj, analiza pragmatike e gjëegjzave dëshmon se ato nuk funksionojnë si pyetje. E tëra kjo i sjell autorët Green dhe Pepicello deri në përfundim se formulat themelore strukturore të fjalëve të urta dhe gjëegjzave janë entimema, që e vërteton ngjashmëria strukturore e këtyre dy zhanreve, të cilën e dëshmon edhe Dundes-i.

2. 2. Forma tekstore

Arsye për një inerferencë të dyanshme ndërmjet fjalës së urtë dhe gjëegjzës është edhe forma tekstore e shkurtër e tyre, për të cilat janë përdorur struktura arkaike të fjalive. Ndërkaq, studiuesja Elli Köngäs-Maranda shton se që të dy këto zhanre kanë edhe ngjashmëri të tjera. Në bazë të hulumtimeve të saja të bëra për gjëegjzat dhe fjalët e urta finlandeze, ajo gjen ngjashmëri tek përshkrimi figurativ që bëhet te disa gjëegjza e që haset edhe te disa fjalë të urta, pothuajse identike. Dallimi është vetëm se

te gjëgjëza, ajo që përshkruhet, duhet të zbulohet, ndërsa te fjalët e urta, ajo që përshkruhet, kuptohet nga konteksti (Maranda,1971:223). Kjo ngjashmëri është edhe pasojë e qëllimit të dy këtyre zhanreve, të cilat janë antropocentrike, të drejtuara kah njeriu dhe prandaj ato shumë lehtë edhe transformohen njëra në tjetrën (Martinoska, 2002:170).

2. 3. Raportet sintagmatike

Sa i përket raporteve interferuese ndërmjet këtyre dy formave në folkloristikën shqiptare, studiuesi Jorgo Panajoti në studimin e tij "Poetika e fjalëve të urta popullore" thekson se fjalët e urta bazohen në raportet e natyrës paradigmatiske, të karakterit virtual (in absentia), ndërsa gjëgjëzat bazohen në raporte sintagmatike (in praesentia). Prandaj gjëgjëzat përdoren vetëm për një objekt ose dukuri dhe janë monovalente, ndërkaq fjalët e urta janë polivalente sepse përdoren më shumë në situata identike e të përafërta (Panajoti,1990:89/1). Kjo mund të jetë edhe arsyeja e ngjashmërisë tematike të këtyre dy formave, te të cilat shpeshherë gjejmë sfera të përbashkëta interesimesh tematike. Prandaj edhe në krijimtarinë tonë gojore, ekzistojnë të ashtuquajturat proverba-gjëza, të cilat janë formulime tërësisht ose pjesërisht identike. P.sh.:

fjalë e urtë:

Hyn e del e tun peshqirë!(Prishtinë,1987:159)

gjëgjëzë:

Hyn e del e tund peshqirë.

qeni (Tiranë,1968:431)

Në këto raste është vështirë që të gjendet se cili nga këto dy zhanre ka pasur ndikim në tjetrin. Po që se në një fjalë të urtë kemi konvencion në të cilin intonacioni dhe mendimi merr formën e një pyetjeje të tërthortë, ai mund të funksionojë edhe si gjëgjëzë. Megjithatë, identifikimi gjëgjëzë-fjalë e urtë është më i zakonshëm për shkak se gjëgjëzat e kanë më të theksuar karakterin enigmatik, por atëherë humbet objekti që kërkohet, si dhe mënjanohej pyetjet tipike për gjëgjëzën, të cilat zëvendësohen me fjalë a shprehje që përdoren para a pas shqiptimit të

fjalës së urtë, *kolaudohet* intonacioni etj., në mënyrë që thënia të mund të funksionojë me vlera normative (Panajoti,1990:85/1). Prandaj, do të shtonim se gjëgjëzat janë enigma të mirëfillta, kurse te proverbat ky karakter enigmatik është i pjesshëm dhe i një shkalle më të ulët.

2. 4. Përfundim

Interferencën ndërmjet gjëgjëzës e fjalës së urtë e përforcon edhe ngjashmëria tematike e këtyre dy zhanreve edhe pse ekziston dallimi në pasqyrimin e objektit të shfaqur në to. Gjëgjëzat e pasqyrojnë anën sendërtore të objektit, lidhjet e jashtme e të rastësishme midis sendeve e dukurive, ndërkaq fjala e urtë atë thelbësoren dhe të ligjshmen. Prandaj edhe nga aspekti didaktik i tyre, këto dy forma dallojnë. Edhe pse gjëgjëzat ndihmojnë në zhvillimin e mprehtësisë mendore dhe njohjen e realitetit që na rrethon, ato nuk pretendojnë që si fjalët e urta të kenë rolin e normës e të sjelljeve e veprimeve të njeriut.

Bibliografia

- BOSKOVIC-STULI (1971), Maja. *Usmena knjizevnost*, Zagreb.
- DUNDES, Alan (1975, 1981), "On the Structure of the Proverb", 25:961-973. Reprinted in Wolfgang Mieder and Alan Dundes, eds., *The Wisdom of Many: Essays Proverbium on the Proverb*. New York: Garland.
- FJALË të urta shqipe* (1987), Rilindja, Prishtinë 1987.
- GREEN, Thomas and PEPICELLO, William (1986), *The Proverb and Riddle as Folk Enthymemes*, revistë elektronike Proverbium 3. [HTTP://WWW.deproverbio.com/DPjournal/DP,6,2,00/PROVERBRIDDLE.html](http://www.deproverbio.com/DPjournal/DP,6,2,00/PROVERBRIDDLE.html)
- [HTTP://WWW.deproverbio.com/DPjournal/DP,4,2,98/KUUSI/AFRICAN.html](http://www.deproverbio.com/DPjournal/DP,4,2,98/KUUSI/AFRICAN.html);
- KÖNGÄS MARANDA, Elli (1971). *The Logic of Riddles*, Struktural Analysis of Oral tradition, edited by Pierre Maranda and Elli Köngäs Maranda, University of Pennsylvania Press, Philadelphia.
- KUUSI, Matti (1969), *Southwest Arican Riddle-Proverbs*, Proverbium 12: 305-311.

MILNER, George (1970). *From Proverb to Riddle and vice versa*, Proverbium 15: 84-85.

PANAJOTI, Jorgo (1990). *Poetika e Fjalëve të Urta Popullore* (tezë doktrature), Tiranë.

PEPICELLO, W.J. and GREEN, Thomas A. (1984), *The Language of Riddles, New Perspectives*, Ohio State University Press: Columbus.

UNIVERSITETI Shtetëror i Tiranës, Instituti i Folklorit (1968), *Folklor shqiptar Gjëgjëza*, Tiranë.

МАРТИНОСКА, Ана (2002). *Поетиката на македонските народни гатанки*, Македонска книга, Shkup.